



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. 4062/1 prot.

Pogradec, më 05.11.2025

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues: **“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, TË TUBACIONEVE NËNTOKËSORE, PËR SHTRIRJEN E LINJAVE NËNTOKËSORE TELEFON, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET”**

Me respekt,

**KRYETARI
Ilir XHAKOLLI**



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i kopjeve: 3 (Tre)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI**

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, DATË ____ / ____ /2025

**PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, TË TUBACIONEVE
NËNTOKËSORE, PËR SHTRIRJEN E LINJAVE NËNTOKËSORE TELEFON,
ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr. 54/2024 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit", VKM-së Nr.851, datë 07.12.2016 "Për Kalimin e të Dhënave mbi Shtrirjen e Rrjetit të Infrastrukturës Inxhinierike të Bashkitë", VKM-së Nr.155, datë 11.3.2022 "Për Miratimin e Rregullave të Përgjithshme për procedurat e Dhënies të së Drejtës së Kalimit për Ndërtimin e Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike me Shpejtësi të Lartë", në VKB-në 133, datë 11.12.2023 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec", si dhe në Relacionin e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (D.K.P.ZH.T), me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim, të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore telefon, energji, tv kabllor, internet.
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Pogradec të lidhë kontrata për marrjen në përdorim të tubacioneve nga subjekte, të cilët do të përmbushin gjithë kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj.
3. Afati maksimal i dhënies në përdorim të jetë jo më shumë se 10 vjet nga data e lidhjes së kontratës.

4. Tarifat për dhënien në përdorim/qera të këtyre tubacioneve nëntokësore, të aplikohen sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec në fuqi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 4062/2 Prot.

Pogradec, më 05.11.2025

RELACION

PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT:

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, TË TUBACIONEVE
NËNTOKËSORE, PËR SHTRIRJEN E LINJAVE NËNTOKËSORE TELEFON,
ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET**

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Ky projekt-vendim ka për objekt miratimin në parim të dhënies në përdorim të tubacioneve kablllore nëntokësore, të cilat janë pjesë e infrastrukturës publike të Bashkisë Pogradec, për nevoja të shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike, energjisë elektrike, TV kabllor dhe internet, nga subjekte të licencuara që ofrojnë këto shërbime.

Bashkia Pogradec çdo vit përballet me kërkesa nga subjekte të ndryshme që ofrojnë shërbime të internetit, energjisë dhe komunikimeve elektronike për vendosjen e kabllave nëntokësore. Mungesa e një procedure të qartë të dhënies në përdorim të tubacioneve ekzistuese shkakton:

- Projekte të përsëritura të gërmimeve në hapësirat publike;
- Dëmtim të infrastrukturës rrugore;
- Kostot e shtuar për riparim;
- Paaftësi për të siguruar kontroll dhe standardizim të rrjeteve.

Miratimi i këtij projekti vendimi:

1. Siguron përdorim të rregullt dhe të kontrolluar të tubacioneve nëntokësore, pa cenuar infrastrukturën.
2. Redukton gërmimet e përsëritura dhe rrit jetëgjatësinë e sipërfaqeve rrugore.
3. Rrit cilësinë e shërbimeve për qytetarët, duke lejuar zgjerimin e rrjeteve me shpejtësi të lartë.
4. Krijon të ardhura të qëndrueshme për Bashkinë, përmes tarifave të parashikuara në vendimet e Këshillit Bashkiak.
5. Siguron transparencë dhe barazi midis operatorëve, me bazë kriteret e përcaktuara në ligj.

Pogradeci bëhet një territor me infrastrukturë moderne dhe të standardizuar në fushën e komunikimeve.

Shërbimet për qytetarët përmirësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Bashkia ruan kontroll, administrim dhe të drejtën për të vendosur kushte teknike e tarife.

KONKLUZION

Duke vlerësuar interesin publik, nevojën për menaxhim të unifikuar të infrastrukturës dhe zhvillimin teknologjik të bashkisë, propozohet miratimi i projekt-vendimit “Për miratimin në parim të dhënies në përdorim të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore telefon, energji, TV kabllor, internet”, referuar neneve 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, VKM-së Nr.851, datë 07.12.2016 “Për Kalimin e të Dhënave mbi Shtrirjen e Rrjetit të Infrastrukturës Inxhinierike të Bashkitë”, VKM-së Nr.155, datë 11.3.2022 “Për Miratimin e Rregullave të Përgjithshme për procedurat e Dhënies të së Drejtës së Kalimit për Ndërtimin e Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike me Shpejtësi të Lartë”, në VKB-në 133, datë 11.12.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec”, si dhe në Relacionin e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (D.K.P.ZH.T), me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak.

Bazuar në argumentet e mësipërme — propozojmë: **Të Miratohet** projekt-vendimi “**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, TË TUBACIONEVE NËNTOKËSORE, PËR SHTRIRJEN E LINJAVE NËNTOKËSORE TELEFON, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET**”

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,

“Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon: **“Akt normativ nënligjor”** është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të

përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike, si dhe standarde të detyrueshme për t'u zbatuar nga subjekte të interesuara, që do të ushtrojë aktivitetin e tyre, në territorin e Bashkisë Pogradec. Ky projekt-vendim ka për objekt miratimin në parim të dhënies në përdorim të tubacioneve kabllore nëntokësore, të cilat janë pjesë e infrastrukturës publike të Bashkisë Pogradec, për nevoja të shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike, energjisë elektrike, TV kabllor dhe internet, nga subjekte të licencuara që ofrojnë këto shërbime në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Ju faleminderit!

Konceptoi: T.FEJZO

Konfirmoi: P.ZIKO

**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**